



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:262710

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06082567

**P.nr.549/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurit S. K. nga fsh. S. K. L., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.5576/23 të datës 08.11.2023, për shkak të veprës penale në vazhdimësi Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në bazë të nenit 229 par.1 dhe 5 të KPPK-së, jashtë seancës gjyqësore, me datën 23.08.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.29/24, e datës 20.08.2024, e lidhur në mes të pandehurit S. K. nga fsh. S. K. L. dhe të dëmtuarit KEDS Distriktit Ferizaj, e lidhur në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan.

**II.HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.5576/23 të datës 08.11.2023.

**III.PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit S. K. nga fsh. S. K. L., shqiptar, shtetas të Republikës së Kosovës, për shkak se të njëjtit kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësuar.

**IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj Prishtinë PP.II.nr.5576/23 të datës 08.11.2023, e ka akuzuar të S. K. nga fsh. S. K. L., për shkak të veprës penale në vazhdimësi Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Palët pra i pandehuri dhe i dëmtuari kanë propozuar që kjo çështje të dërgohet në procedurën e ndërmjetësimit dhe gjykata me dt.01.07.2024 e ka referuar rastin në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 20.08.2024, në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të t'pandehurit S. K. dhe të dëmtuarit KEDS Distriktit Ferizaj, në prani të zyrtarit së ndërmjetsimit të autorizuar nga institucioni i ndërmjetsimit ndërmjetsuesit Ali Gashi.

Në seancën e ndërmjetësimit palët kanë arritur marrëveshjen me vullnetin e tyre të plotë dhe nuk kontestojnë asnjërën nga pikat e lartshënuara për të cilat pajtohen njëzëri.

Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan, me datën 23.08.2024, ka pranuar marrëveshjen e palëve me numër Nd.nr.29/24, të nënshkruar me të datën 20.08.2024, për zgjidhjen e ndërmjetësimit.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN**  
**P.nr.549/23 të datës 23.08.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
Gentiana Dakaj

**Gjyqtari**  
Avdirrahman Gashi

**UDHEZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2023:262710  
Datë: 23.08.2024  
Numri i dokumentit: 06082567